



**Hapet Thirrja për mobilitete (bursa) studentësh të UPT-së
në kuadër të Marrëveshjes KA1, të Programit Erasmus+
në Universidad Politécnica de Cartagena, Spanjë.**

Në kuadër të marrëveshjes KA1 bilaterale, është hapur thirrja për aplikime për bursa për mobilitete për studentë të Universitetit Politeknik të Tiranës, në Universidad Politécnica de Cartagena - UPCT.

Llojet e mobilitetit përfshijnë: Shkëmbimin e studentëve për studime.

Studentët duhet të jenë të regjistruar në një program studimi në Universitetin Politeknik të Tiranës, **Fakulteti i Inxhinierisë së Ndërtimit, Fakulteti i Arkitekturës dhe Urbanistikës, Fakulteti i Teknologjisë së Informacionit, Fakulteti i Inxhinierisë Elektrike** dhe të kenë përfunduar vitin e parë akademik.

Numri total i studentëve: 2 (Seleksionimi final bëhet nga UPCT.)

Koha e mobilitetit: Semestri i parë i vitit akademik 2025 - 2026

Dokumentat e nevojshme për aplikim për studentët:

- CV;
- Kopje e Pasaportës;
- Vërtetim studentit;
- Listë notash e studimeve deri në momentin e aplikimit (Academic transcript of records and achievement);
- Letër Motivimi (në gjuhën angleze);
- Çertifikatë e gjuhës së huaj* (*English or Spanish Language Competency (B2 or higher according to the CEFR)*);
- Dokumenti Learning Agreement**.

**Ofrohen kurset e studimit në gjuhën angleze ku niveli minimal i kërkuar është B2. Studenti duhet të plotësojë nivelin minimal të kërkuar gjuhën duke e vërtetuar me çertifikatën përkatëse të gjuhës së huaj.*

***Learning Agreement është një kontratë midis universitetit të origjinës dhe aplikantit dhe shërben për të përcaktuar lëndët që do të zhvillohen në universitetin pritës. Ju duhet të plotësoni vetëm seksionin e parë "Mobility Plan". Në tabelën A përcaktohen lëndët dhe kreditet që do të merrni në universitetin pritës, në tabelën B përcaktohet se cilat prej lëndëve të Tabelës A do të njihet në Universitetin Politeknik të Tiranës kur ju të kenë përfunduar periudhën e shkëmbimit.*

KUJDES: Ju duhet të përzgjidhni të kryeni në UPCT lëndë të njëjta ose ekuivalente me ato që do të kryenit në semestrin përkatës në fakultetin tuaj, kjo për arsye që lëndët dhe kreditet t'ju njihen kur të ktheheni. Nëse lëndët e përzgjedhura ndryshojnë nga ata që do të zhvillohen në fakultetin tuaj semestrin përkatës, atëherë kur të ktheheni ju duhet të zhvilloni lëndët që nuk përshtaten në Universitetin Politeknik të Tiranës. Dokumenti "Learning Agreement" te seksioni "Commitment" firmoset nga aplikanti, nga Koordinatori Akademik i Fakultetit dhe nga Zv/Rektori i UPT-së për Anën Shkencore dhe Marrëdhëniet me Jashtë.

Formati "Learning Agreement" gjendet bashkëlidhur.

Afati për aplikim, pranë Drejtorisë së Komunikimit dhe Koordinimit në UPT: Deri më 5 maj 2025, ora 12.00.

Për informacione shtesë në lidhje me procesin e aplikimit në UPT mund të kontaktoni në email: rkodra@upt.al , abeqo@upt.al

Për t'u njohur me lëndët që ofrohen në UPCT, sipas niveleve dhe fushave të studimit, klikoni te: [Incoming | International Relations | Polytechnic University of Cartagena \(upct.es\)](https://www.upct.es)



UNIVERSITETI POLITEKNIK I TIRANËS

Key Action 1
- Mobility for learners and staff -





UNIVERSITETI POLITEKNIK I TIRANËS

Key Action 1
- Mobility for learners and staff -

